



Duke u bazuar ne Ligjin nr.03/L Për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren nr.02/2010 Për Rekrutimin e Sherbyesve Civil,Zyra Rregullatore për Ujësjiellës dhe Mbeturina Shpall:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Ligj dhe Licenca

Nr.Referencës : 03/11

Departamenti: Ligj dhe Licenca

Raporton te: Kryesuesi i Departamentit për Ligj dhe Licenca

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli administrativ

Niveli i pagës: III

Orari i punës: I Plotë

Kontrata: Një vjeçare (3 muaj punë provuese) me mundësi të vazhdimit

FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI I POZITËS

Zyrtari për Ligj dhe Licenca përcjelljë evaulimin e ligjeve aktuale në sektorin e ujrave dhe mbeturinave, udhëheqë procesin e aplikimit për licencim të shërbimit si dhe për administrimin e procesit të licencimit sipas afateve dhe dispozitave të dhëna në Rregullën për Licencim.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Ndërmerr aktivitete përgatitore dhe udhëheq procedurat tekniko administrative për Amendamentim dhe Licencim, për të cilat raporton Kryesuesin e DL&L;
- Ndihmon dhe përkrah në gjitha format gjatë procesit të Amendamentimin të akteve nënligjore etj;
- Propozon forma dhe procedura për Amendamentim dhe Licencim;
- Vepron si person kontaktues i ZRRUM-it për çështjet e Ofrueseve të Shërbimeve lidhur me plotësimin dhe dorëzimin e Amendamenteve dhe aplikacioneve për licencë;
- Informon Ofruesit e Shërbimeve lidhur me cilindo informacion që mungon apo që nuk është i kompletuar;
- Bën shqyrtim paraprak të aplikacioneve për licencim të dorëzuara lidhur e kompletimin administrativ për të cilat përgatit raport;
- Kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme që kanë të bëjnë me lëshimin e Licencës së Shërbimit të Ofruesve të Shërbimeve;
- Bën koordinimin me agjencitë tjera përkatëse në Kosovë (MMPH, IKSHPK) lidhur me statusin dhe informacionet e dhëna për aplikimin për licencë, shqyrtimin dhe aprovimin;
- Udhëheqë hulumtimin mbi çështjet që dalin nga Ofruesit e Shërbimeve, Qeveria dhe palët tjera të interesit;
- Monitoron dhe raporton lidhur me mos respektimin e legjislacionit primar dhe sekondar nga Ofruesit e Shërbimit të licencuar;
- Monitoron dhe raporton lidhur me zbatimin e Amendamenteve të fuqizuara;

- Monitoron dhe raporton për përmbushjen e kushteve të Licencës së Shërbimit;
- Bënë monitorim at hoc sipas kërkesës së Kryesuesit të DL&L;
- Mban Procesverbale nga Takimet e mbajtura;
- Mban evidencën e korrespondencës të DL&L;
- Mban evidencën lidhur me shkyçjet kolektive;
- Përgatit dhe dorëzon raporte e rregullta të punës si dhe sipas kërkesës;
- Kryen edhe punë tjera sipas nevojës së ZRRUM-it dhe kur kjo të kërkohet nga eprorët e tij/saj të drejtpërdrejt.

KUALIFIKIMET

- Të këtë të kryer Fakultetin Juridik;
- Përvoja e punës përparësi;
- Njohuri mbi administratën e institucioneve të Kosovës;
- Njohuri të punës në të folur dhe të shkruar të gjuhëve që janë në përdorim zyrtar në Kosovë, e mirëpritur është njohja e gjuhës angleze;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter duke përfshirë Word dhe punën me tabela në Excel;
- Aftësi të theksuara të komunikimit;
- Aftësi për të punuar nën presion;
- Të këtë Patentë shoferi valid.

DATA E FUNDIT PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE: 16 Dhjetor 2011

Formulari për aplikim mund të merret pranë Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga te gjitha komunitetet ne Kosove.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Rr. Ferat Dragaj, 68, Bregu i Diellit Prishtinë (prapa furrës Qerimi 1)

Tel. +381 38 249 165 110;113 www.wwro-ks.org

DO TË KONTAKTOHEN VETËM KANDIDATËT QË HYJNË NË LISTEN E NGUSHTË